



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Projekti:

Ndërtimi i Serrave

(Subvencione në kuadër të sektorit të perimtarisë: Ngritja e 10 Serra me sipërfaqe 50m² dhe 11 Serra me sipërfaqe 150m²)

Gjakovë, Prill 2023

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – DBPZHR:

Njofton fermerët e Komunës së Gjakovës që mund të aplikojnë në skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me **Serra me sipërfaqe 50 dhe 150m²**.

KRITERET:

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve - pesë(5) rajone;
- Fermerët femra, të rinjë dhe minoritetet kanë përparësi;
- Përfituesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës dhe parcela ku do të ngritet serra duhet të jetë në territorin e Komunës së Gjakovës;
- Përfituesi duhet të bashkëfinancojë vlerën e subvencionit (serres) minimum 20%;
- Aplikuesi mos të jetë përfitues i skemës së subvencioneve të Drejtorisë nga viti aktual dhe paraprak;
- Aplikuesi për serrë me sipërfaqe 50m² duhet të ketë së paku 0.5 ha tokë të punueshme;
- Aplikuesi për serrë me sipërfaqe 150m² ha duhet të ketë së paku 1.00 ha tokë të punueshme;
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një dimension të serrës;
- Fermeri i cili dorëzon 2 fletë aplikacione eliminohet menjëherë nga përkrahja në fjalë;
- Fermerët të cilet do të futen në listë të ngushtë do të verifikohen në terren nga komisioni vlerësues;
- Për serrat me sipërfaqe 50m² kanë përparësi personat me gjendje të vështirë ekonomike.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letër njoftimi fotokopje;
- Numri identifikues i fermerit (NIF – kopje);
- Vërtetimi i Tatimit në pronë;
- Çertifikata mbi pronësinë e paluajtshme – Lista poseduese (kopje);

Fletë aplikacioni tërhiqet pranë zyrave të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Gjakovës (Rr: Bardhyl Qaushi, ish objekti i BVI-se)

Afati i aplikimit: 13.04.2023-28.04.2023.